

Lokucionet foljore në Fjalorin e Frang Bardhit

Mr. Agim Spahiu

19 tetor 2006

Përmbledhje

Në këtë shkrim autori është marrë me trajtimin e kategorisë gjuhësore të lokucioneve në fjalorin e njohur të **Frang Bardhi** *DICTIONARIUM LATINO EPIROTIKVM*, botuar në vitin 1635 në Romë. Autori nxjerr konstatimin se lokucionet në këtë vepër janë të shumta dhe përbëjnë një begati të madhe gjuhësore të trashëguar edhe për kohën e sotme. Kjo njësi gjuhësore, në fund të kësaj trajtесе, është përqsur teorikisht me frazeologjizmat të cilët janë përdorur, po ashtu, mjaft shumë nga ana e Bardhit në këtë Fjalor të rëndësishëm për fushën e leksikografisë shqiptare.

Ky shkrim në formë kumtese është prezantuar në programin e Sesionit shkencor, kushtuar 450 vjetorit të lindjes së Frang Bardhit, i cili u mbajt më 23.11.2006 në Institutin Albanologjik të Prishtinës.

Fjalori LATINISHT - SHQIP ose DICTIONARIUM LATINO EPIROTIKVM i Frang Bardhit¹ është njëra prej veprave më të rëndësishme në historinë e leksikografisë shqiptare. Madje sipas D. Zavalanit me këtë Fjalor zë fill leksikologjia, ndaj me të drejtë Bardhi quhet edhe leksikologu i parë në historinë e gjuhës shqipe².

Rëndësia e këtij fjalori për gjuhësinë është e shumëfishtë dhe studiuesit e saj sot mund t'i qasen nga shumë anë e aspekte. Por ne në këtë vështrim do ta përqendrojmë vëmendjen vetëm në çështjen e përdorimit të lokucioneve foljore në këtë **Fjalor**.

Cilido studiues që e merr në dorë këtë **fjalor**, me një shfletim sado të përciptë, nuk e ka vështirë të vijë në një përfundim se ky fjalor është mjaft i pasur jo vetëm me lokucione e frazeologjizma, por edhe me fjalë të urta, shprehje të moçme popullore, idioma etj. Dhe për mendimin tonë, këto shprehin origjinalitetin dhe identitetin e çdo gjuhe, prandaj edhe të gjuhës sonë.

Në këtë **fjalor** kemi parë se ndërtimi më i shpeshtë i lokucioneve foljore është ai i tipit **FOLJE + EMËR** (pa ose me parafjalë), për të cilin tip do të bëjmë fjalë në vazhdim të

¹Për hartimin e kësaj trajtесе kam shfrytëzuar fjalorin e Frang Bardhit DICTIONARIUM LATINO EPIROTIKVM, i hedhur në origjinal në www.shqiptarortodoks.com/tekste/albanologji/bardhi.html, nga Michiel de Vaan në maj të vitit 2004.

²Nga një shkrim i Dilaver Zavalanit, botuar në faqen e internetit: www.shkoder.net/al/bio, në të cilin flet për jetën dhe veprimtarinë e Frang Bardhit.

kësaj trajtëse. Por nuk do t' i lëmë pa i përmendur as tipat e tjera dhe ato të prejardhura prej tyre.

Ato i gjejmë kudo si në parathënie e në kuadër të fjalorit, ashtu edhe në pjesën ku përfshihet një numër i konsiderueshëm proverbash në gjuhën tonë. Në këtë kontekst gjejmë lokucionet foljore, si: *εuna fil/ me εane fjl*, *me marre uesct/vesct*, *me εane besse*, *me baam εaa*, *me baam mcat*, *kaa εacon*, *me passune spresse*, *chisc dro* (kish dro, A. S.), *asct nevoie*, *me mare frūme*, *me baam pagh*, *me mbeleξε basch*, *me nzierre εee*, *me baam uçe*, *me baam mbee*, *smān benee*, *me baam mreculij*, *me baam mbsüüs*, *me raam mnot*, *me baam spenze*, *me baam desmignenij*, *me baam calabbe*, *me baam hie*, *me baam piesse*, *me maitune mend*; *smerξene ndemend*; *membaitun nde mend* - lat. *memini* (nr. rendor. 57) etj., të pasqyruara në shembujt e mëposhtëm: *εuna fil tue cheξüem chete* Ditionar mbe ghiuhet tane, ... (Nga parathënia e fjalorit, në fillim); *as nuche marrene vesct ghisc εone*, ... (Nga parathënia); ... *mundeni me εane*, *e me marre uesct* ngihuhet ze Latine ghisc u ascte neuoie... (Nga parathënia e fjalorit, në faqen e dytë); *Sduhet me εane besse as uijt*, *as Turchut*. (Nga Proverbia et sententiae Epirotarum, nr. 96.); *Chisc droe hoi perse suienξ* (Salutation Epiroticae linguae, haec est, nga gr. 220); *me marre frūme-lat. anhelare dhe spirare*, (nr. rendor. 12 e 57); *me embleξε basche* - *coaceruare dhe complicare*, (nr. rendor. 12 e 14); *me baam pagh* (paqe - nënviz. im A. S) - *cosiliare* (nr. rend. 14); *me baam uçe* - *itinerari* (nr. rend. 42); *me baam mbee* - *iurare* (nr. rend. 43); *me baam mreculij* - *mirificare* (nr. rend. 59); *me baam mbsüüs* (mësysh - nënvizim imi, A. S.); *me raam mnot* - *Natare* (nr. rend. 64); *me bam desmignenij* - *testificare* (nr. rend. 173); *me baam calabbe* (me ba zhurmë, nënviz. imi, A. S.); *me baam piesse* - *participare* (nr. rend. 83); *me baam εaa* - *rugire dhe sonare*; *me passune spresse* - *sperare* (nr. rend. 157); *ka εacon* - *solet* (nr. rend. 155); *me baam εaa* - *sonare* (nr. rend. 156); *me vum cundre* - *opponere* (nr. rend. 78) etj.

Në këtë **Fjalor të Bardhit** na bien në sy aty - këtu edhe disa lokucione emërore të sajuara nga ato foljore, si p. sh. *te εanet fjl*, por edhe - *fill* - *exordium* (nr. rend. 23), *tu vurit cusc*, *e εinima besse*, *mbegna besse*, *ter mbaitune nde mend* - lat. *memoria* (nr. rendor 57) etj., si *te shembujt* (*pasi preca nde te εanet fjl te chesaai lettere*), ... *e scume fialle mei vum Arbenist: e εinima besse*, ... ; (faqja e dytë e parathënies); ... *o? tu vurit cusc Kallaucine*, *paa rene terretit sdiyne cuξ me marre*, ... (Po aty, faqja e dytë) etj.

Në këtë **fjalor** ne kemi parë edhe disa lokucione foljore me ndërtim: **Folje + ndajfolje** (që në disa raste gjymtyra e fundit del si një emër me parafjalë) si p. sh. : *me lane mbane* - lat. *omittere*, *me ngaam rend* - lat. *currere*, *mbetune giaal*, - lat. *viuere*, *me u baam gatij*, *me u uum nbenga ane* - lat. *seponere* (me u vum nbënja anë, A. S.); *me baam buεene nbe gac* - lat. *subridere*, *me mbetune sendos* (shëndosh, A. S.) - lat. *sospitare*, *me arçune perchrach-lat. obuersari*; *me baam medijtone* - lat. *nunciare* (kjo e fundit me ndërtim folje + paskajore e gegërishtes me pjesëzën - me) etj.

Në këtë Fjalor gjejmë edhe disa njësi frazeologjike foljore, si fjala vjen: *me ncheξüem spatlete oó spinene* - lat. *tergiuersari*; *mprefen ξambete* - lat. *inspicat dents*; *me ξüem fialene*, - lat. *obrogare*; *me mbetune mbe fialet*, *mos me lueitun memend* - lat. *vacillare*; *me dale nde fuscet* - lat. *prodire*; ... *me stremenuem buεete*, *me scundune crüete mbe vepera te tiereue*, *ma me vum dorene mbe Pendet...* (Nga pjesa: *Te falunite*, fq. 223); *Ai ghi ξen fialene* (jep fjalënë, A. S.), *bie nde fialete* - *interpellator* (nr. rendor 39);

Nde gnanet vesh me hijn, e per tieterit me del. (Proverbat, nr. rend. 74) etj., të cilat, po të shikohen pak me vëmendje, janë bukur të afërta me lokucionet. Pra, kanë shumë veçori të përbashkëta dhe, për këtë arsye, shumë studiues ato i ngatërrojnë, sepse për ta lokucionet janë thjesht frazeologjizma dhe frazeologjizmat lokucione.

Mirëpo ne në këtë shkrim do të bëjmë përpjekje që në pika të shkurtra t'i vëmë në pah disa tipare a veçori dalluese të tyre, si më poshtë:

Së pari, njësitë frazeologjike foljore, marrë në përgjithësi, janë ndërtime të qëndrueshme, me përbërës kryesisht të pandashëm, me një shkallë relativisht të lartë monoliciteti, pra, me një rend të ngulitur të elementeve përbërëse. Dhe çdo ndryshim a ndërrim i këtyre elementeve përbërëse, sidomos i trajtës emërore, mund t'ua ndryshojë krejtësisht kuptimin e tyre dhe si rezultat i kësaj ato ka mundësi që të kthehen në togfjalësha të lirë a sintaksorë (p. sh. krahaso: *vë dorë* > *vë dorën në...* ; *heq dorë* > *heq dorën nga...* ; etj.), ose në disa rasteve edhe të shkuptimësohen krejtësisht. Kurse në anën tjetër, lokucionet foljore kanë një shkallë më të ulët të qëndrueshmërisë a ngurtësisë së elementeve përbërëse, sepse lidhja në mes fjalëve përbërëse të tyre është paksa më e brishtë. Prandaj këto të fundit qëndrojnë në kapërcyell në mes ndërtimeve të qëndrueshme dhe bashkimeve të lira të fjalëve.

Së dyti, njësitë frazeologjike foljore përdoren me kuptim të figurshëm, pra me kuptimin e dytë. P. sh., frazeologjizmi **(ia) ktheu shpinën/kurrizin/** përdoret me kuptimin *e braktisi, nuk kujdeset më për të*; ose **shet mend** me kuptimin *përpiqet të tregohet më i ditur a më i zoti sesa është a mburret përpara të tjerëve*³. Ndërsa lokucionet foljore përdoren kryesisht me kuptimin e tyre të parë, jo të figurshëm. Dhe secili prej nesh me lehtësi e vëren se lokucionet: *vë re, kam dëshirë, marr pjesë, (nuk) kam qejf, (i) bëj ballë, (i) zë besë, (ia) ka ënda* etj., në vete nuk kanë kuptim të figurshëm.

Së treti, njësitë frazeologjike foljore, në të shumtën rasteve, e kanë një bazë të njohur ose të panjohur motivuese. Dhe kjo bazë motivuese është e sajuar nga momente të caktuara të ngjarjeve a ndodhjeve të ndryshme nëpër të cilat historikisht ka kaluar shoqëria jonë. Kurse sa u përket lokucioneve foljore, në përgjithësi, me ndonjë përjashtim të vogël a të pjesëshëm (ka disa idioma që në të kaluarën e largët, sigurisht se e kanë pasur ndonjë bazë përfaqësuese motivuese, si fjala vjen idioma foljore *vë re* mendohet të jetë formuar nga **vë roe* me kuptimin kur dikush dikujt i *vë roje*), mirëpo sot ato konsiderohen si ndërtime të desemantizuara a të demotivuara nga ky aspekt.

Së katërti, njësitë frazeologjike foljore janë ndërtime më komplekse sa i përket zëbrthimit të tyre nga ana kuptimore, ngase shpesh herë ndodh që të kenë më shumë se një kuptim, varësisht nga konteksti i përdorimit të tyre. P. sh. frazeologjizmi *(m'u) bë gjaku ujë* përdoret me kuptimet: 1) u frikova, u tremb shumë; 2) u shqetësova pa masë, u mërzi, u zemërova shumë⁴. Ky kompleksitet i tyre del edhe në strukturën e tyre, sepse shumë njësi frazeologjike, në përgjithësi, e sidomos ata foljore, jo vetëm që dalin me strukturën e togfjalëshit, por edhe të fjalisë, madje edhe të një fjalisë të përbërë, siç e pamë më lart te shembulli i Frang Bardhit në proverbin **Nde gnanet vesh me hijn, e per tieterit me del** (= me kuptimin *s'dua të kuptoj fare, nuk mban në mend fare, nuk i intereson të*

³Shih FGJSSH, Tiranë, 1980, fq.829.

⁴Shih FGHSSH, fq.2081.

dij a të kuptoj diçka - A. S.), kurse lokucionet foljore, si për nga struktura, ashtu edhe për nga kuptimi, janë më të thjeshta për t'u zbërthyer. Madje asnjëherë nuk dalin me strukturë fjalie.

Dhe së fundi, elementet përbërëse të frazeologjizmave foljorë e kanë kuptimin e mëvetësishëm leksikor, kurse ato të lokucioneve nuk e kanë gjithmonë këtë mëvetësi, ngase ka shumë raste kur ato janë të ndërtuara nga një fjalë me kuptim të mëvetësishëm, porse fjala tjetër përbërëse është vetëm në shërbim të saj, pra është një fjalë ndihmëse a funksionale. (Krahaso: foljet: bëj, marr, zë, vë etj., në ndërtimet: bëj be, bëj zë, bëj udhë, bëj pjesë, bëj gat, (i) bëj nder dikujt etj. ; mori guximin, mori frikë, mori nën mbrojtje; i zë besë, zë fill; i vë besë, vë inat, i vuri kufi etj.).

Prandaj, duke i marrë për bazë të gjitha këto që thamë deri këtu, vijmë te përfundimi se ndërtimet frazeologjike foljore duhet të dallohen doemos nga lokucionet përkatëse foljore, jo vetëm nga emërtimi i tyre, por edhe nga veçoritë përmbajtësore dalluese. Prandaj të parat kushtimisht mund t'i konsiderojmë edhe si ndërtime leksikore, kurse të dytat më tepër si ndërtime gramatikore, sepse janë të gramatikalizuara. Prandaj me të parat merret kryesisht disiplina frazeologjisë, kurse me të dytat gramatika. Por kjo nuk do të thotë se në mes tyre nuk ka pikëpërkime. Ato janë të shumta dhe shpesh here është vështirë t'u vihet atyre një kufi i prerë, çështje kjo që është paksa e vështirë, prandaj kërkon një trajtim shumë më të gjerë e të gjithanshëm.